



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:240520

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05643222

P.nr.32/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit J. M. nga fsh. D. K. F., të cilin e mbron Veton Robaj av. nga Prishtina, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.4038/22 të dt.29.12.2022, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 29.04.2024, në prani të prokurores së shtetit Hava Krasniqi, të pandehurit, mbrojtësit Veton Robaj av. nga Prishtina dhe të dëmtuarit F. P. nga F. dhe në mungesë të dëmtuarit A. T. nga F., ndërsa me datën 30.04.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

J. M., i lindur më dt...., me vendbanim fsh. D. në F. dhe me vendbanim të përkohshëm në Z., ku edhe tani jeton, nga i ati Z., nënës H., mbiemri i vajzërisë së nënës C., kontabilist, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. letërnjoftimi ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt.24.07.2022, rreth orës 01:00h, në Lipjan, në autostradën "A. Xh.", nga drejtimi F. – P., në kilometrin e 8, i pandehuri J. M., derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës "...", ngjyrë e zezë, me tabela të regjistrimit ..., nga pakujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoi komunikacionin, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit, duke rrezikuare jetën e njerëzve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 53.1 dhe 233 të Ligjit mbi bazat e sigurisë së trafikut, /Nr.05/L-88/, i cili duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit ndaj kushteve të krijuar në komunikacion, gjatë natës kur dukshmëria ka qenë e zvogëluar, dhe nën ndikimin e alkoolit 0.52% alkool në gjak, e humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit, ku fillimisht i godet mbrojtëset metalike të anës së majtë, e pastaj i goditur mbrojtëset metalike të anës së djathtë, dal jashtë rrugë dhe përfundon në kanalën e ujarëve atmosferike, me ç' rast në këtë vetë aksident pasagjeret në automjetin "...", F. P. pëson lëndime të rënda trupore, ndërsa pasagjeri tjetër A. T. pëson lëndim të lehtë trupor, dhe shkaktohet aksident komunikacioni me dëme materiale,

-me këtë e ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69 dhe neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, si dhe neni 364 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet konform dispozitës 44 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumë prej 1,800.00.-€, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmerise së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform neni 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

Të dëmtuarit: F. P. nga fsh. P. i M. K.F. dhe A. T. nga F., udhëzohen që kërkesën pasuroro juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt civile.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 200 euro (150 euro për ekspertizë të komunikacionit dhe 50 euro në emër të ekspertizës mjeko-ligjore), në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4038/22 të dt.29.12.2022, e ka akuzuar të pandehurin J. M. nga fsh. D. K. F., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse ky pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në dispozitat e KPPK-së, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë dhe i njëjti të shpillet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari F. P. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se kjo ka ndodhur padashje, jemi shokë dhe se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe është i penduar për këtë aksident dhe deri te ky moment ka ardhur një kamion përball me drita të gjata ku e ka humbur drejtimin, ndihet shumë i penduar dhe i ka kërkuar falje shokëve dhe është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të pandehurit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pas konsultimit me të mbrojturin dhe me vullnetin e tij i cili ka ardhur nga shtetet e jashtme për këtë seancë për ta përfundu këtë çështje, duke kërkuar nga gjykata dhe i ka propozuar një dënim sa më të butë meqenëse as të dëmtuarit nuk kërkojnë ndjekjen penale dhe të cilët janë kompensuar për dëmet nga siguruesi të pandehurit. Gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që duke marur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që i ka përmendur klienti i tij, faktin se i njëjti jeton jashtë vendit dhe është mbajtës i familjes dhe një dënim me burgim do ti shkaktoj probleme jashtë vendit lidhur me punësimin, dhe do ti shkaktonte vështërsi familjarve fëmijëve dhe prindërve të tij dhe një dënim apo zëvendësim të dënimit me gjobë do të ishte më i përshtatshëm për të sepse kjo që i ka ndodh ka ndiku veq pozitivisht për sjelljen e tij në komunikacion.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajit nuk është rezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore

e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPPK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhme mund të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë, është mbajtës i familjes, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale, me të dëmtuarit janë pajtuar pasi që janë edhe shokë në mes veti dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin, pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke ia zëvendësuar dënimin me burgim me dënim me gjobë me pëlqimin e të pandehurit dhe konform nenit 44 të KPPK-së, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ u caktua në emër të paushallit gjyqësor në bazë të ndërlikshmërisë së rastit, shuma prej 200 euro (150 euro për ekspertizë të komunikacionit dhe 50 euro në emër të ekspertizës mjeko-ligjore), ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së, dhe gjykata e udhëzoi të dëmtuarin që për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore pasi që në këtë procedurë penale gjykata nuk ka pasur prova për të vërtetuar lartësinë e dëmit të shkaktuar.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.32/23 dt.30.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:240520
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05643222